



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 96

Tiranë – E enjte, 4 maj 2017

PËRMBAJTJA

Faqe

Udhëzim i përbashkët i Ministrit të
Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe
Ministrit të Shëndetësisë
nr. 7, datë 21.4.2017

“Mbi zbatimin e vendimit nr. 431 datë 8.6.2016 të Këshillit të
Ministrave për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit,
procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së
kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e
të detyrave të tyre në zonat pilot”

5377

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 7, datë 21.4.2017****MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 431
DATË 8.6.2016 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT,
PROCEDURAVE DHE TË MASËS PËR
PËRFITIMIN E PAGESËS SË AFTËSISË
SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT
PERSONAL DHE TË STRUKTURAVE
PËRGJEGJËSE E TË DETYRAVE TË
TYRE NË ZONAT PILOT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, nenit 42/3 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar, vendimit nr. 431, datë 8.6.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”,

UDHËZIJMË:

1. Në vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar që do të pilotohet në njësitë administrative nr. 6 dhe nr. 7, të qarkut të Tiranës, nëpërmjet përdorimit të Regjistrit Elektronik Kombëtar do të përfshihen:

a) individët që kërkojnë të vlerësohen për herë të parë;

b) individët që kërkojnë të rivlerësohen, të cilët kanë përfituar pagesë të aftësisë së kufizuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Personi i cili plotëson kriteret sipas pikës 1 të kreut II të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016 të Këshillit të Ministrave ka të drejtën të drejtohet për vlerësim komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë të kufizuar.

3. Çdo individ i cili pretendon të vlerësohet për aftësi të kufizuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar duhet të paraqitet pranë strukturave shëndetësore për të kryer vizitë mjekësore dhe ekzaminimet e nevojshme, fillimisht pranë mjekut të familjes dhe më pas referohet pranë mjekut specialist.

4. Mjeku i familjes në qendrën e kujdesit shëndetësor parësor plotëson formularin nr. 1 për të rritur ose formularin nr. 2 për fëmijë, sipas anekseve bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Mjeku specialist pranë qendrës shëndetësore të specialiteteve/Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor/Qendrës Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve plotëson në mënyrë të pavarur të njëjtët formularë me ato të mjekut të familjes, formularin nr. 1 për të rritur ose formularin nr. 2 për fëmijë sipas anekseve bashkë-lidhur këtij udhëzimi.

6. Individit që kërkon të vlerësohet për aftësi të kufizuar apo kujdestari i tij ligjor, dorëzon pranë Komisionit Shumëdisiplinor dokumentacionin e mëposhtëm:

a) formularin e plotësuar nga mjeku i familjes;

b) formularin e plotësuar nga mjeku specialist;

c) formularin e aplikimit të plotësuar nga vetë individit apo kujdestari i tij ligjor, për vlerësimin e përcaktimit të aftësisë së kufizuar sipas aneksit nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

ç) ekzaminimet mjekësore;

d) kopjen e kartës së identitetit/certifikatën personale.

7. Punonjësi i komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar kryen detyrat e mëposhtme:

a) hedh të dhënat e aplikantit dhe të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 6 të këtij udhëzimi në regjistrin elektronik kombëtar të aftësisë së kufizuar;

b) Verifikon të dhënat e marra nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar për aplikantin dhe kur nuk është e mundur verifikon në mënyrë manuale me institucione të tjera të cilat duhet të kthejnë përgjigje brenda 10 ditëve dhe hedh këto të dhëna në Regjistrin Elektronik Kombëtar;

c) kur vëren se dokumentacioni nuk është i plotë apo nevojiten ekzaminime shtesë e kthen atë për plotësim, në rast të kundërt cakton datën e intervistës brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendrike nga data e marrjes së dokumenteve të aplikimit apo në një afat më të shkurtër për rastet për të cilat kërkohet procedurë e përshpejtuar dhe njofton zyrtarisht aplikuesin.

8. Individit duhet të paraqitet pranë komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për të kryer intervistën në datën dhe orën e përcaktuar nga ky komision. Për rastet kur mos-paraqitja ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme si shëndetësore apo fatkeqësi, data e intervistës do të përcaktohet në afatin më të afërt



por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita që është provuar shkaku i mosparaqitjes.

9. Aplikuesi ka të drejtë ta kërkojë zhvillimin e intervistës në adresën e banimit të tij/saj në rastet kur është e pamundur fizikisht kryerja e vlerësimit në ambientet ku zhvillon veprimtarinë komisioni, për shkak të një dëmtimi të rëndë ose të thellë që e bën të pamundur paraqitjen e tij pranë komisionit ose për shkak të barierrave. Për intervistën në banesë, personi duhet të pajiset me rekomandimin e mjekut të familjes, ose të mjekut specialist. Anëtarët e familjes nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë zhvillimit të intervistës, përveç rasteve të kujdestarisë ligjore.

10. Komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në prani të individit dhe/ose kujdestarit të tij ligjor sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes, kryen intervistën dhe hedh të dhënat në Regjistrin Elektronik Kombëtar për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar sipas formularit nr. 4 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe të dhënat për vlerësimin dhe përcaktimin e nevojës për ndihmësin personal sipas formularit nr. 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Gjatë intervistës, aplikuesi (ose përfaqësuesi ligjor) i përgjigjet pyetjeve mbi kufizimet funksionale që e pengojnë në ushtrimin e veprimtarive të jetesës së përditshme dhe pjesëmarrjen në jetën sociale, ekonomike, politike, si edhe barierrat mjedisore e faktorët lehtësues.

11. Komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar, për përcaktimin e nevojës për ndihmësin personal, shqyrton edhe përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara në formularin nr. 4 për “Aktivitetet, pjesëmarrjen, barrierat mjedisore dhe lehtësuesit” dhe formularin nr. 5 “Për përcaktimin e nevojës për ndihmësin personal”.

12. Në përfundim të procesit të vlerësimit komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar përcakton nivelin e përgjithshëm të aftësisë së kufizuar sipas formularit nr. 6 dhe përgatit certifikatën e aftësisë së kufizuar formati i së cilës përcaktohet në formularin nr. 7 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

13. Të dhënat e përfutuara gjatë intervistimit janë të dhëna zyrtare, konfidencialiteti i të cilave mbrohet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 3.10.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

14. Individit njoftohet me shkrim në lidhje me vendimin e komisionit, procedurat dhe afatet e

ankimimit, afatin e dorëzimit të dokumentit që vërteton kryerjen e kontrollit vjetor dhe pajiset me certifikatën e aftësisë së kufizuar e cila përmban të dhëna mbi vlerësimin bio-psiko-social, përfitimet, rekomandime për shërbime, kohëzgjatjen, etj.

15. Institucionet shëndetësore të kujdesit parësor/dytësor, marrin pjesë në realizimin e kontroleve periodike të nevojshme duke realizuar vizitën mjekësore të kontrollit vjetor për të cilën plotësojnë formularin nr. 8 sipas aneksit bashkëlidhur këtij udhëzimi, së bashku me dokumentacionin mjekësor të nevojshëm mbështetës, të cilën individit e dorëzon pranë komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Në bazë të të dhënave të këtij formulari nëse gjendja e individit është përmirësuar apo rënduar komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar vendos ose jo për rivlerësim të individit duke e njoftuar edhe për datën e daljes në komision dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë.

16. Anëtarët e komisionit multidisciplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar lëshojnë rekomandime për shërbime mjekësore rehabilituese, të cilët përmbushen nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore të çdo niveli.

17. Anëtarët e komisionit multidisciplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar lëshojnë rekomandime për arsimimin, formimin profesional dhe punësimin e përshtatshëm të individit, të cilat përmbushen nga institucionet arsimore dhe Drejtoria Rajonale e Punësimit.

18. Anëtarët e komisionit multidisciplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar lëshojnë rekomandime për shërbime shoqërore dhe shërbime të tjera, të cilat përmbushen nga ofruesit e shërbimeve publike, jopublike apo organizata të ndryshme nëpërmjet ndërmjetësimit të strukturave të shërbimeve sociale pranë pushtetit vendor.

19. Zyrtat e shërbimeve shoqërore në njësitë administrative/bashki i japin informacionin e nevojshëm aplikuesve mbi dokumentacionin dhe procesin e vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar dhe përfitimeve për shkak të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes shoqërore.

20. Zyrtat e shërbimeve shoqërore në njësitë administrative/bashki:

a) hartojnë planin individual bazuar mbi informacionin e përfutur nga vlerësimi i aftësisë së kufizuar dhe rekomandimet për shërbime;



b) garantojnë marrjen e shërbimeve nga institucione publike, jopublike dhe organizata.

21. Zyrtat e shërbimeve shoqërore në njësitë administrative/bashki mbështesin dhe monitorojnë shërbimet e ndihmës personal.

22. Drejtoritë e Shërbimeve Shoqërore në Bashki hartojnë listën e përfituesve ekzistues të cilën ia përcjellin Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror njëkohësisht me listën e përfituesve që propozohen për tu trajtuar me ndihmë ekonomike sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar.

23. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror i dërgon kryetarit të Bashkisë vendimin për të kryer veprimet financiare për kryerjen e pagesës për përfituesit ekzistues të aftësisë së kufizuar, kujdestarët e tyre, invalidët e punës si edhe për personat me aftësi të kufizuar dhe ndihmës të tyre personal të vlerësuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

24. Administratori shoqëror i njësisë administrative hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat e përfituesve ekzistues të pagesave të aftësisë së kufizuar, kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuar dhe invalidëve të punës, që përfitojnë nga programi i mbrojtjes sociale.

25. Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit sipas përcaktimeve në kreun V të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016. Komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar hedh të dhënat në Regjistrin Elektronik Kombëtar dhe njofton ankimuesin mbi vendimin e marrë nga rishqyrtimi i ankesës.

26. Për rastet kur ka një vendim të formës së prerë të Gjykatës Administrative, komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar hedh të dhënat në Regjistrin Elektronik Kombëtar dhe për rastet kur kërkesa është pranuar personit i lindë e drejta e marrjes së përfitimeve që nga muaji pasardhës nga data e marrjes së vendimit për refuzim nga komisioni ose sipas përcaktimeve në vendimin e gjykatës.

27. Individët e përcaktuar në kreun I pika 2 germa (a) të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e

të detyrave të tyre në zonat pilot”, trajtohen me pagesë sipas përcaktimeve në kreun IV të këtij vendimi.

28. Individët e përcaktuar në kreun I pika 2 germa (b) të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”, trajtohen me pagesë sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997 të ndryshuar; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006 të ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001 të ndryshuar.

29. Nuk i nënshtrohen procedurës së vlerësimit në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi:

a) përfituesit ekzistues sipas vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të cilët janë të verbër invalidë pune, si edhe të verbrit, të cilëve u ka lindur e drejta për t’u trajtuar me pension pleqërie/social sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) përfituesit ekzistues sipas pikave 1 dhe 2, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara” të ndryshuar, të cilëve u ka lindur e drejta për t’u trajtuar me pension pleqërie/social sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) pikës 1, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik e tetraplegjik”, të ndryshuar të cilëve u ka lindur e drejta për t’u trajtuar me pension pleqërie/social sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

30. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi për zonat pilot, Shërbimi Social Shtetëror, Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, strukturat e shërbimit shëndetësor parësor dhe dytësor, Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor, Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të fëmijëve, njësitë e qeverisjes vendore dhe të gjitha institucionet e tjera që do të shkëmbejnë informacionin



dhe ofrojnë shërbim sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË

Olta Xhaçka

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ogerta Manastirliu



FORMULAR APLIKIMI

VLERËSIMI MJEKËSOR PËR PËRCAKTIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR
PËR TË RRITUR

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: E-mail: Web:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. Emri i Babait		4. NID Nr. i identifikimit personal	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	Data Muaji Viti
7. Vendlindja			
9. Adresa			
10. Qyteti			
12. Kodi Postar		11. Rrethi	
14. E-mail		13. Nr. Tel	
		15. Nr. Sig shëndetësor	

SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI MJEKUN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. NID Nr. i identifikimit personal		4. Specialiteti	
5. Adresa			
6. Qyteti			
8. Kodi Postar		7. Rrethi	
10. E-mail		9. Nr. Tel	

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Plotësoni fushat e mëposhtme në lidhje me aftësinë e kufizuar të pacientit tuaj. Informacioni do të përdoret si evidencë mjekësore mbi kërkesën për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar. Specifikoni gjendjen mjekësore të pacientit dhe si ajo ndikon në aktivitetet e jetës së përditshme të tij/saj.

1. A është kjo hera e parë që ju e vizitoni pacientin për rekomandim të përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar?
☐ Po ☐ Jo

2. Kohëzgjatja e trajtimit të pacientit

3. Numri i trajtimeve të pacientit në 12 muajt e fundit

4. Diagnoza kryesore e pacientit

Data e përcaktimit (Viti)

5. Diagnoza të tjera (nëse ka)

Data e përcaktimit (Viti)

Data e përcaktimit (Viti)



Data e përcaktimit (Viti)

Data e përcaktimit (Viti)

6. Gjetjet klinike dhe rezultatet e të gjitha testeve mjekësore apo analizave laboratorike që lidhen me këtë vizitë

7. Trajtimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Trajtimet

Rezultatet e trajtimeve

8. Funkcionet trupore që janë dëmtuar si rezultat i gjendjes shëndetësore, si dhe shkalla e dëmtimit me numrin përkatës, referuar renditjes së mëposhtme

- 0 Asnjë dëmtim**, do të thotë që personi nuk ka problem (0-5%)
- 1 Dëmtim i lehtë**, do të thotë që problemi është i pranishëm në më pak se 35% të kohës, me një intensitet që personi mund të tolerojë dhe që ndodh rrallë përgjatë 30 ditëve të fundit (6-35%)
- 2 Dëmtim i moderuar**, do të thotë që problemi është i pranishëm në më shumë se 35% të kohës, por më pak se 50% të kohës, me një intensitet, i cili ndikon në jetën e përditshme të individit dhe që ndodh me raste përgjatë 30 ditëve të fundit (36-50%)
- 3 Dëmtim i rëndë**, do të thotë që një problem është i pranishëm për më shumë se 50% të kohës, por më pak se 90%, me një intensitet, i cili në mënyrë të pjesshme prish jetesën e përditshme të personit dhe ndodh në mënyrë të vazhdueshme përgjatë 30 ditëve të fundit (51-90%)
- 4 Dëmtim i plotë**, do të thotë që problemi është i pranishëm për më tepër se 95% të kohës, me një intensitet që shkatërron në mënyrë totale jetesën e përditshme të personit dhe që ndodh çdo ditë përgjatë 30 ditëve të fundit (91-100%)
- 8 Jo specifikuar**, do të thotë që nuk ka informacion të mjaftueshëm për të specifikuar ashpërsinë e dëmtimit

FUNKSIONET MENDORE (b1)
(specifiko dhe përshkruaj)

Shkalla e dëmtimit
0 1 2 3 4 8

□ □ □ □ □ □

[illegible]

FUNKSIONET NDIJORE DHE DHIMBJA (b2)
(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8

□ □ □ □ □

FUNKSIONET E ZËRIT DHE LIGJËRIMIT (b3)
(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8

□ □ □ □ □ □

[illegible]

FUNKSIONET E SISTEMIT KARDIOVASKULAR, HEMATOLOGJIK,
IMUNOLOGJIK DHE TË FRYMËMARRJES (b4)
(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8

□ □ □ □ □ □

Specify the person(s)

FUNKSIONET E SISTEMEVE TË TRETJES, METABOLIZMIT
DHE GJËNDRAVE ENDOKTRINE (b5)
(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8

□ □ □ □ □ □



Shkalla e dëmtimit

0 1 2 3 4 8

FUNKSIONET GJENITOURINARE DHE TË RIPRODHIMIT (b6)

(specifiko dhe përshkruaj)

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

--

FUNKSIONET NEURO-MUSKULO-SKELETORE DHE ATO

TË LIDHURA ME LËVIZJEN (b7)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

(specifiko dhe përshkruaj)

--

FUNKSIONET E LËKURES DHE STRUKTURAT E LIDHURA ME TË (b8)

(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

--

ÇDO FUNKSION TJETËR TRUPOR QË NUK PËRFSHIHET MË SIPËR (b9)

(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

--



9. Strukturat trupore që janë dëmtuar si rezultat i gjendjes shëndetësore, si dhe shkalla e dëmtimit me numrin përkatës, referuar renditjes së mëposhtme

A: Shkalla e dëmtimit

- 0 - Asnjë dëmtim (0-5%)
- 1 - Dëmtim i lehtë (6-35%)
- 2 - Dëmtim mesatar (36-50%)
- 3 - Dëmtim i rëndë (51-90%)
- 4 - Dëmtim i plotë/i thellë (91-100%)

B: Natyra e ndryshimit

- 5 - Jo ndryshime në strukturë
- 6 - Mungesë totale
- 7 - Mungesë e pjesshme
- 8 - Pjesë të shtuara
- 9 - Dimensione anormale
- 10 - Ndërprerje
- 11 - Pozicion i devijuar
- 12 - Ndryshime cilësore në strukturë, përfshirë akumulimin e lëngjeve
- 13 - Të paspecifikuara
- 14 - Të paaplikueshme

C: Vendi i dëmtimit

- 0 - Më shumë se një zonë
- 1 - Djathtas
- 2 - Majtas
- 3 - Të dyja anët
- 4 - Përpara
- 5 - Prapa
- 6 - Proksimal
- 7 - Skajor
- 8 - E paspecifikuar
- 9 - E paaplikueshme

Kategoritë e funksioneve trupore
(plotëso vetëm kur është e zbatueshme)

Shkalla e
dëmtimit

Natyrë e
ndryshimit

Vendi i
dëmtimit

STRUKTURAT E SISTEMIT NERVOR (s1)
(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)

☐
☐
☐

SYRI, VESHI DHE STRUKTURAT E TJERA TË LIDHURA ME TO (s2)
(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)

☐
☐
☐

STRUKTURAT, PËRFSHIRË ATO NË ZË DHE LIGJËRIM (s3)
(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)

☐
☐
☐



	Shkalla e dëmtimit	Natyra e ndryshimit	Vendi i dëmtimit
STRUKTURAT E SISTEMEVE KARDIOVASKULARE, IMUNOLOGJIKE DHE RESPIRATORE (s4) <i>(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)</i>	☐	☐	☐
STRUKTURAT E LIDHURA ME SISTEMET E TRETJES, METABOLIZMIT DHE ENDOKRINALE (s5) <i>(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)</i>	☐	☐	☐
STRUKTURAT E LIDHURA ME SISTEMET GJENITALE DHE TË RIPODHIMIT (s6) <i>(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)</i>	☐	☐	☐
STRUKTURAT E LIDHURA ME LËVIZJEN (s7) <i>(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)</i>	☐	☐	☐
LËKURA DHE STRUKTURAT E LIDHURA ME TË (s8) <i>(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)</i>	☐	☐	☐



ÇDO STRUKTURË TJETËR TRUPORE QË NUK ËSHTË PËRFSHIRË MË SIPËR (s9)
(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)

Shkalla e
dëmtimit

☐

Natyrë e
ndryshimit

☐

Vendi i
dëmtimit

☐

10. Plotësoni fushat e kufizimit të aktiviteteve të jetesës së përditshme dhe pengesave për të realizuar pjesëmarrjen në aktivitete bazë të moshës, të ardhura këto si rezultat i gjendjes shëndetësore. Shënoni numrin më të përshtatshëm që përcakton shkallën e kufizimit.

* Kini parasysh që aktiviteti është kryerja e detyrave apo veprimeve nga një individ, ndërsa pjesëmarrja është përfshirja e tij/saj në një situatë jetësore. Kufizimet në aktivitete janë vështirësi që një individ mund të ketë në kryerjen e aktiviteteve. Pengesat në pjesëmarrje janë probleme, të cilat një individ mund t'i ketë në përfshirjen në një situatë jetësore. Cilësori i performancës tregon shkallën e kufizimeve në pjesëmarrje, duke përshkruar performancën aktuale të personit në lidhje me një detyrë apo veprim në mjedisin e tij/saj.

0 - Pa Vështirësi (0-5%)

1 - Vështirësi e lehtë, do të thotë që problemi është i pranishëm më pak se 35% të kohës, me një intensitet që personi mund të tolerojë dhe që ndodh rrallë përgjatë 30 ditëve të fundit (5-35%)

2 - Vështirësi e moderuar, do të thotë që problemi është i pranishëm më pak se 50% të kohës, me një intensitet, i cili ndikon në jetën e përditshme të individit dhe që ndodh me raste përgjatë 30 ditëve të fundit (36-50%)

3 - Vështirësi e rëndë, do të thotë që një problem është i pranishëm për më shumë se 50% të kohës, me një intensitet, i cili në mënyrë të pjesshme prish jetesën e përditshme të personit dhe ndodh në mënyrë të vazhdueshme përgjatë 30 ditëve të fundit (51-90%)

4 - Vështirësi e plotë, do të thotë që problemi është i pranishëm për më tepër se 90% të kohës, me një intensitet që shkatërron në mënyrë totale jetesën e përditshme të personit dhe që ndodh çdo ditë përgjatë 30 ditëve të fundit (91-100%)

8 - Jo specifikuar, do të thotë që nuk ka informacion të mjaftueshëm për të specifikuar shkallën e vështirësisë

Kufizimet me aktivitete dhe pjesëmarrjen

(plotëso vetëm kur është e zbatueshme)

TË NXËNIT DHE ZBATIMI I NJOHURIVE

(Të parët e të dëgjuarit me vëmendje, të lexuarit, të shkruarit,

aftësia për të llogaritur, zgjidhja e problemeve, marrja e vendimeve, etj) (d1)

(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

Niveli i vështirësisë

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

KRYERJA E DETYRAVE DHE NEVOJAVE TË PËRGJITHSHME

(Kryerja e një detyre të vetme, kryerja e detyrave të shumëfishta, zbatimi i rutinës ditore, përballimi i stresit, kontrolli i sjelljes, etj) (d2)

(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐



KOMUNIKIMI

(Marrja dhe dhënia e mesazheve, të folurit, përdorimi shenjave për të folur, komunikimi me shkrim, bashkëbisedimi i lidhur, diskutimi, përdorimi i aparateve dhe teknikave të komunikimi, etj) (d3)

(specifikjo dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

Niveli i vështirësive

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

LËVIZSHMËRIA

(Të ndryshuarit e pozicionit të trupit pa ndihmë, zhvendosja e trupit, ngritja dhe mbajtja e objekteve, përdorimi i duarve, të ecurit pa ndihmë, të lëvizurit përmes përdorimit të pajisjeve si psh. karrige me rrota etj, përdorimi i transportit si makina, autobusi, treni, aeroplani, etj, pa ndihmë, të drejtuarit e makinës dhe të ngarët e biçikletës) (d4)

(specifikjo dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

KUJDESI PËR VETEN

(Të larët e vetvetes, larja e duarve etj, kujdesi për pjesët e trupit si larja e dhëmbëve, të veshurit, të rruarit etj., vajtja në tualet, të ngrënë, të pirët, të kujdesurit për shëndetin e tij/saj, etj) (d5)

(specifikjo dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

JETESA E PËRDITSHME

(Marrja e të mirave dhe shërbimeve si të bërit pazar, etj, përgatitja e vakteve si të gatuarit, etj, bërja e punëve të shtëpisë si gatimi, pastrimi i shtëpisë, larja e rrobave, hekurosja, kujdesi për objektet shtëpiake dhe ndihma ndaj të tjerëve, etj) (d6)

(specifikjo dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐



NDËRVEPRIMET DHE MARRËDHËNIET PERSONALE
(Ndërveprimet personale bazë, komplekse, marrëdhëniet me familjarët dhe të tjerët, marrëdhëniet intime romantike dhe/ose seksuale, etj) (d7)
(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

Niveli i vështirësive

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

FUSHAT KRYESORE TË JETËS
(Realizimi i arsimit, punësimi i paguar i pjesshëm apo i plotë, transaksionet bazë ekonomike, aftësia për të nxjerrë të ardhura, etj) (d8)
(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

JETA KOMUNITARE, SOCIALE DHE QYTETARE
(Jeta në komunitet, çlodhja, argëtimi dhe koha e lirë, jeta politike dhe pjesëmarrja qytetare, pjesëmarrja në aktivitetet fetare, etj) (d9)
(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

ÇDO AKTIVITET APO PJESEMARRJE TJETER (d10)
(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8


☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

11. Mendoni që aftësia e kufizuar e pacientit apo dëmtimi mund të zgjasë për më shumë se një vit?

☐ Po ☐ Jo

12. Si mund të ndryshojë në kohë aftësia e kufizuar/diagnoza e pacientit

☐ Aftësia e kufizuar nuk do të ndryshojë ☐ Aftësia e kufizuar mund të ndryshojë





FORMULAR APLIKIMI



VLERËSIMI MJEKËSOR PËR PËRCAKTIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR
PËR FËMIJË

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
MINISTRIA E MIRËOENIES SOCIALE DHE RINISË



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: E-mail: Web:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
<i>Shënim:</i> Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. Emri i Babait		4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	 <i>Data Muaji Viti</i>
7. Vendlindja		8. Shtetësia	
9. Adresa			
10. Qyteti		11. Rrethi	
12. Kodi Postar		13. Nr. Tel	
14. E-mail		15. Nr. Sig shëndetësor	

SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI MJEKUN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>		4. Specialiteti	
5. Adresa			
6. Qyteti		7. Rrethi	
8. Kodi Postar		9. Nr. Tel	
10. E-mail			

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Plotësoni fushat e mëposhtme në lidhje me aftësinë e kufizuar të pacientit tuaj. Informacioni do të përdoret si evidencë mjekësore mbi kërkesën për përfitimë për shkak të aftësisë së kufizuar. Specifikoni gjendjen mjekësore të pacientit dhe si ajo ndikon në aktivitetet e jetës së përditshme të tij/saj.

1. A është kjo hera e parë që ju e vizitoni pacientin për rekomandim të të përfitimt të pagesës së aftësisë së kufizuar?
☐ Po ☐ Jo

2. Kohëzgjatja e trajtimit të pacientit

3. Numri i trajtimeve të pacientit në 12 muajt e fundit

4. Diagnoza kryesore e pacientit

5. Diagnoza të tjera (nëse ka)



Data e përcaktimit (Viti)

Data e përcaktimit (Viti)

6. Gjetjet klinike dhe rezultatet e të gjitha testeve mjekësore apo analizave laboratorike që lidhen me këtë vizitë

7. Trajtimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Trajtimet

Rezultatet e trajtimeve

8. Funkcionet trupore që janë dëmtuar si rezultat i gjendjes shëndetësore, si dhe shkalla e dëmtimit me numrin përkatës, referuar renditjes së mëposhtme

- 0 **Asnjë dëmtim**, do të thotë që personi nuk ka problem (0-5%)
- 1 **Dëmtim i lehtë**, do të thotë që problemi është i pranishëm në më pak se 35% të kohës, me një intensitet që personi mund të tolerojë dhe që ndodh rrallë përgjatë 30 ditëve të fundit (6-35%)
- 2 **Dëmtim i moderuar**, do të thotë që problemi është i pranishëm në më shumë se 35% të kohës, por më pak se 50% të kohës, me një intensitet, i cili ndikon në jetën e përditshme të individit dhe që ndodh me raste përgjatë 30 ditëve të fundit (36-50%)
- 3 **Dëmtim i rëndë**, do të thotë që një problem është i pranishëm për më shumë se 50% të kohës, por më pak se 90%, me një intensitet, i cili në mënyrë të pjesshme prish jetesën e përditshme të personit dhe ndodh në mënyrë të vazhdueshme përgjatë 30 ditëve të fundit (51-90%)
- 4 **Dëmtim i plotë**, do të thotë që problemi është i pranishëm për më tepër se 95% të kohës, me një intensitet që shkatërron në mënyrë totale jetesën e përditshme të personit dhe që ndodh çdo ditë përgjatë 30 ditëve të fundit (91-100%)
- 8 **Jo specifikuar**, do të thotë që nuk ka informacion të mjaftueshëm për të specifikuar ashpërsinë e dëmtimit



Kategoritë e funksioneve trupore
(plotëso vetëm kur është e zbatueshme)

Shkalla e dëmtimit
0 1 2 3 4 8

FUNKSIONET MENDORE (b1)
(specifiko dhe përshkruaj)

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

FUNKSIONET NDIJORE DHE DHIMBJA (b2)
(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8
☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

FUNKSIONET E ZËRIT DHE LIGJËRIMIT (b3)
(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8
☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

FUNKSIONET E SISTEMIT KARDIOVASKULAR, HEMATOLOGJIK,
IMUNOLOGJIK DHE TË FRYMËMARRJES (b4)
(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8
☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

FUNKSIONET E SISTEMEVE TË TRETJES, METABOLIZMIT
DHE GJËNDRAVE ENDOKTRINE (b5)
(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8
☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐



Shkalla e dëmtimit

0 1 2 3 4 8

FUNKSIONET GJENITOURINARE DHE TË RIPRODHIMIT (b6)

(specifiko dhe përshkruaj)

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

FUNKSIONET NEURO-MUSKULO-SKELETORE DHE ATO

TË LIDHURA ME LËVIZJEN (b7)

(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

FUNKSIONET E LËKURES DHE STRUKTURAT E LIDHURA ME TË (b8)

(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

ÇDO FUNKSION TJETËR TRUPOR QË NUK PËRFSHIHET MË SIPËR (b9)

(specifiko dhe përshkruaj)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐



9. Strukturat trupore që janë dëmtuar si rezultat i gjendjes shëndetësore, si dhe shkalla e dëmtimit me numrin përkatës, referuar renditjes së mëposhtme

A: Shkalla e dëmtimit

- 0 - Asnjë dëmtim (0-5%)
- 1 - Dëmtim i lehtë (6-35%)
- 2 - Dëmtim mesatar (36-50%)
- 3 - Dëmtim i rëndë (51-90%)
- 4 - Dëmtim i plotë/i thellë (91-100%)

B: Natyra e ndryshimit

- 5 - Jo ndryshime në strukturë
- 6 - Mungesë totale
- 7 - Mungesë e pjesshme
- 8 - Pjesë të shtuara
- 9 - Dimensione anormale
- 10 - Ndërprerje
- 11 - Pozicion i devijuar
- 12 - Ndryshime cilësore në strukturë, përfshirë akumulimin e lëngjeve
- 13 - Të paspecifikuara
- 14 - Të paaplikueshme

C: Vendi i dëmtimit

- 0 - Më shumë se një zonë
- 1 - Djathtas
- 2 - Majtas
- 3 - Të dyja anët
- 4 - Përpara
- 5 - Prapa
- 6 - Proksimal
- 7 - Skajor
- 8 - E paspecifikuar
- 9 - E paaplikueshme

Kategoritë e funksioneve trupore
(plotëso vetëm kur është e zbatueshme)

STRUKTURAT E SISTEMIT NERVOR (s1)
(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)

Shkalla e
dëmtimit

Natyra e
ndryshimit

Vendi i
dëmtimit

☐
☐
☐

SYRI, VESHI DHE STRUKTURAT E TJERA TË LIDHURA ME TO (s2)
(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)

☐
☐
☐

STRUKTURAT, PËRFSHIRË ATO NË ZË DHE LIGJËRIM (s3)
(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)

☐
☐
☐

STRUKTURAT E SISTEMEVE KARDIOVASKULARE, IMUNOLOGJIKE DHE RESPIRATORE (s4)
(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)

☐
☐
☐



	Shkalla e dëmtimit	Natyra e ndryshimit	Vendi i dëmtimit
STRUKTURAT E LIDHURA ME SISTEMET E TRETJES, METABOLIZMIT DHE ENDOKRINALE (s5) <i>(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)</i>	☐	☐	☐
STRUKTURAT E LIDHURA ME SISTEMET GJENITALE DHE TË RIPRODHIMIT (s6) <i>(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)</i>	☐	☐	☐
STRUKTURAT E LIDHURA ME LËVIZJEN (s7) <i>(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)</i>	☐	☐	☐
LËKURA DHE STRUKTURAT E LIDHURA ME TË (s8) <i>(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)</i>	☐	☐	☐
ÇDO STRUKTURË TJETËR TRUPORE QË NUK ËSHTË PËRFSHIRË MË SIPËR (s9) <i>(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)</i>	☐	☐	☐



10. Plotësoni fushat e kufizimit të aktiviteteve të jetesës së përditshme dhe pengesave për të realizuar pjesëmarrjen në aktivitete bazë të moshës, të ardhura këto si rezultat i gjendjes shëndetësore. Shënoni numrin më të përshtatshëm që përcakton shkallën e kufizimit.

* Kini parasysh që aktiviteti është kryerja e detyrave apo veprimeve nga një individ, ndërsa pjesëmarrja është përfshirja e tij/saj në një situatë jetësore. Kufizimet në aktivitete janë vështirësi që një individ mund të ketë në kryerjen e aktiviteteve. Pengesat në pjesëmarrje janë probleme, të cilat një individ mund t'i ketë në përfshirjen në një situatë jetësore. Cilësori i performancës tregon shkallën e kufizimeve në pjesëmarrje, duke përshkruar performancën aktuale të personit në lidhje me një detyrë apo veprim në mjedisin e tij/saj.

0 - Pa Vështirësi (0-5%)

1 - Vështirësi e lehtë, do të thotë që problemi është i pranishëm më pak se 35% të kohës, me një intensitet që personi mund të tolerojë dhe që ndodh rrallë përgjatë 30 ditëve të fundit (5-35%)

2 - Vështirësi e moderuar, do të thotë që problemi është i pranishëm më pak se 50% të kohës, me një intensitet, i cili ndikon në jetën e përditshme të individit dhe që ndodh me raste përgjatë 30 ditëve të fundit (36-50%)

3 - Vështirësi e rëndë, do të thotë që një problem është i pranishëm për më shumë se 50% të kohës, me një intensitet, i cili në mënyrë të pjesshme prish jetesën e përditshme të personit dhe ndodh në mënyrë të vazhdueshme përgjatë 30 ditëve të fundit (51-90%)

4 - Vështirësi e plotë, do të thotë që problemi është i pranishëm për më tepër se 90% të kohës, me një intensitet që shkatërron në mënyrë totale jetesën e përditshme të personit dhe që ndodh çdo ditë përgjatë 30 ditëve të fundit (91-100%)

8 - Jo specifikuar, do të thotë që nuk ka informacion të mjaftueshëm për të specifikuar shkallën e vështirësisë

Kufizimet në aktivitete dhe pjesëmarrjen

(plotëso vetëm kur është e zbatueshme)

TË NXËNIT DHE ZBATIMI I NJOHURIVE

(Përvojat e qëllimshme shqisore, të mësuarit bazë, marrja e informacionit, mësimi i gjuhës, mësimi i leximit,

mësimi i shkrimit, mësimi i llogaritjeve bazë, përfitimi i aftësive të thjeshta dhe të ndërlikuara, problemeve,

marrja e vendimeve, zbatimi i njohurive, leximi, shkrimi, llogaritja, zgjidhja e problemeve, marrja e vendimeve, etj) (d1)

(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

Niveli i vështirësisë

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

KRYERJA E DETYRAVE DHE NEVOJAVE TË PËRGJITHSHME

(Kryerja e një detyre të vetme, kryerja e detyrave të shumëfishta, zbatimi i rutinës ditore, përballimi i stresit, kontrolli i sjelljes, etj) (d2)

(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

KOMUNIKIMI

(Marrja dhe dhënia e mesazheve verbale dhe/ose joverbale, të folurit, përdorimi i shenjave për të folur, komunikimi me shkrim, bashkëbisedimi, diskutimi, përdorimi i aparateve dhe teknikave të komunikimit, etj) (d3)

(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐



Niveli i vështirësive

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

LËVIZSHMËRIA

(Të ndryshuarit e pozicionit të trupit pa ndihmë, zhvendosja e trupit, ngritja dhe mbajtja e objekteve, përdorimi i duarve, të ecurit pa ndihmë, të lëvizurit përmes përdorimit të pajisjeve si psh. karrige me rrota etj, përdorimi i transportit si pasagjerë) (d4)
(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

KUJDESI PËR VETEN

(Të larët e vetvetes, larja e duarve etj, kujdesi për pjesët e trupit si larja e dhëmbëve, të veshurit, rregullimi i urinimit dhe defekimit, të ngrënët, të pirët, të kujdesurit për shëndetin e tij/saj) (d5)
(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

JETESA E PËRDITSHME

(Marrja e të mirave dhe shërbimeve si të bërit pazar, etj, përgatitja e vakteve si të gatuarit, etj, bërja e punëve të shtëpisë si gatimi, pastrimi i shtëpisë, larja e rrobave, hekurosja, kujdesi për objektet shtëpiake dhe ndihma ndaj të tjerëve, etj) (d6)
(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

NDËRVEPRIMET DHE MARRËDHËNIET PERSONALE

(Ndërveprimet personale bazë, komplekse, marrëdhëniet me familjarët dhe të tjerët, marrëdhëniet intime romantike dhe/ose seksuale, etj) (d7)
(specifiko dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐



FUSHAT KRYESORE TË JETËS

(Arsimi joformal, arsimi formal, trajnimi profesional, punësimi i paguar i pjesshëm apo i plotë, përgatitja për punë, transaksionet bazë ekonomike, aftësia për të nxjerrë të ardhura, angazhimi në lojë, etj) (d8)

(specifikoj dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

Niveli i vështirësive

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

JETA KOMUNITARE, SOCIALE DHE QYTETARE

(Jeta në komunitet, çlodhja, argëtimi dhe koha e lirë, jeta politike dhe pjesëmarrja qytetare, pjesëmarrja në aktivitetet fetare, etj) (d9)

(specifikoj dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

CDO AKTIVITET APO PJESEMARRJE TJETER (d10)

(specifikoj dhe përshkruaj kufizimet dhe pengesat)

0 1 2 3 4 8

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

11. Mendoni që aftësia e kufizuar e fëmijës apo dëmtimi mund të zgjasë për më shumë se një vit?

☐ Po ☐ Jo

12. Si mund të ndryshojë në kohë aftësia e kufizuar/diagnoza e fëmijës ?

☐ Aftësia e kufizuar nuk do të ndryshojë ☐ Aftësia e kufizuar mund të ndryshojë

13. Ka ndonjë faktor tjetër, i cili nuk është adresuar në pyetjet më lart, për të cilin ju besoni që mund të ndikojnë në aftësinë e fëmijës për të funksionuar normalisht në jetën e përditshme, në përputhje me kërkesat e moshës?

☐ Po ☐ Jo

Nëse po, specifikoj



SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

Bashkëngjisni të gjitha dokumentet/shënimet e duhura mjekësore, klinike dhe laboratorike që ju keni për pacientin dhe përdorni hapësirën më poshtë për çdo koment apo informacion shtesë që ju mendoni është i nevojshëm.

--

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nënshkrimi i mjekut

--

Data		Muaji		Viti			



FORMULAR APLIKIMI

VLERËSIMI I PËRCAKTIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: E-mail: Web:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. Emri i Babait		4. NID Nr. i identifikimit personal	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	
7. Vendlindja		8. Shtetësia	
9. Adresa			
10. Qyteti		11. Rrethi	
12. Kodi Postar		13. Nr. Tel	
14. E-mail		15. Nr. Sig Shëndetësor	

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

1. A keni aplikuar më parë për të marrë përfitime të aftësisë së kufizuar?	☐ Po	☐ Jo
2. A keni marrë përfitime të aftësisë së kufizuar më parë?	☐ Po	☐ Jo
3. Në cilën kategori bëni pjesë? (zgjidh vetëm një mundësi, më të përshtatshmen për rastin tuaj)		
Mbi moshën 18 vjeç		
☐ I/e punësuar	☐ I/e vetëpunësuar	☐ I/e papunë
☐ Shtëpiak/e	☐ Pensionist/e	☐ Qendër ditore
☐ Student ☐ Tjetër (specifiko)		
Nën moshën 18 vjeç		
☐ Çerdhe	☐ Kopësht	☐ Nxënës
☐ Tjetër (specifiko)		
4. Historiku i punësimit (nëse është i aplikueshëm)		
Qendra e punësimit		
	nga	
	nga	
	nga	
Periudha e punësimit		
	deri më	
	deri më	
	deri më	



5. Arsimi

☐ Pa arsim ☐ Fillor ☐ 9 vjeçar ☐ I mesëm ☐ I lartë

Numri i viteve të plotësuar

6. A keni pasur ndonjëherë përfitime nga Sigurimet Shoqërore?

☐ Po ☐ Jo

7. Nëse po, çfarë lloj përfitimi?

☐ Aftësi e Kufizuar ☐ Pension Pleqërie ☐ Tjetër (specifiko)

8. Përfitimet e aftësisë së kufizuar, për të cilat po aplikoni

☐ Teknologji ndihmëse/Karrige me rrota ☐ Përfitime financiare ☐ Ndihmës personal
☐ Përfitimi i arsimit ☐ Përkthyes i gjuhës së shenjave ☐ Telefon
☐ Paketë higjieno-sanitare ☐ Udhëtimi me autobus

9. A kërkonti vizitë mjeksore dhe intervistë në shtëpi?

(vetëm në rastet kur kërkuesi nuk mund të lëvizë nga vendbanimi i tij/saj për shkak të nevojave të tij/saj mjekësore ose barrierat e rënda të aksesueshmërisë)

☐ Po ☐ Jo

10. Mënyra e kontaktimit

☐ Postë elektronike (e-mail)
☐ Telefon
☐ Postë
☐ Nëpërmjet administratorit social të komunës/bashkisë

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

- ☐ Certifikatë Personale lindje me një fotografi të bërë gjashtë muajt e fundit (për aplikantët nën 16 vjeç)
☐ Fotokopje e letërnjoftimit
☐ Formulari i plotësuar nga mjeku i familjes/pediatri (brenda muajit të fundit)
☐ Formulari i plotësuar nga mjeku specialist/Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor (brenda muajit të fundit)
☐ Formulari i plotësuar nga qendra e shërbimeve (nëse aplikohet)

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.

Nënshkrimi i aplikantit

Data		Muaji		Viti			

Nënshkrimi i personit të autorizuar

Data		Muaji		Viti			



FORMULAR APLIKIMI

VLERËSIMI PËR PËRCAKTIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR
AKTIVITETET, PJESEMMARRJA, BARRIERAT MJEDISORE DHE LEHTËSUESIT

SHËRBIMI SOCIAL SHETËROR
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË



Nëse kenë pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: E-mail: Web:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë, ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri		2. Mbiemri	
3. Emri i Babait		4. NID Nr. i identifikimit personal	
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	
7. Vendlindja		8. Shtetësia	
9. Adresa			
10. Qyteti		11. Rrethi	
12. Kodi Postar		13. Nr. Tel	
14. E-mail		15. Nr. Sig shëndetësor	
16. Arsimi		17. Nr i viteve të plotësuar	
18. Niveli më i lartë arsimor i arritur	☐ Fillor ☐ I lartë	☐ 9-vjeçar ☐ Pasuniversitar	☐ I mesëm ☐ Pa arsim
19. Punësimi aktual	☐ Punësim i paguar ☐ Student/nxënës ☐ Papunë, por kërkon punë ☐ Tjetër (specifiko) 	☐ Vetëpunësuar ☐ Shtëpiak/e ☐ Papunë (arsye shëndetësore)	☐ Jo punësim i paguar/vullnetar ☐ Pensionist ☐ Nuk është e aplikueshme
20. Mënyra e të jetuarit	☐ Vetëm ☐ Bashkëshortin dhe fëmijët	☐ Me prindërit ☐ Anëtarë të familjes	☐ Bashkëshortin/en ☐ Tjetër (specifiko)

SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI PERSONIN E AUTORIZUAR

BURIMI I INFORMACIONIT

☐ I afërm/anëtar i familjes	☐ Kujdestar (jo anëtar i familjes)
1. Emri	
2. Mbiemri	
3. Emri	
4. Mbiemri	



SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Qëllimi i këtij formulari është të mbledhë informacion mbi aftësinë e kërkuesit për të kryer aktivitetet e jetës së përditshme, sipas moshës, si edhe të identifikojë mbështetjen e nevojshme. Gjatë plotësimit të këtij pyetësori, përdorni informacionin e dhënë nga kërkuesi, paraqitësi i kërkesës dhe/ose anëtarët e familjes, të cilët janë të pranishëm. Gjithashtu, përdorni dokumentet e paraqitura si dhe vëzhgimin tuaj të drejtpërdrejtë.

KUFIZIMET E AKTIVITETIT DHE KUFIZIMET E PJESËMARRJES

Cilësorët e aftësive

0 - Aspak vështirësi do të thotë se personi nuk ka probleme (0-5%)

1 - Vështirësi e lehtë do të thotë se problemi është i pranishëm më pak se 35% të kohës, me një intensitet që personi mund ta tolerojë dhe ndodh rrallë në 30 ditët e fundit (6-35%)

2 - Vështirësi e moderuar/e mesme do të thotë se problemi është i pranishëm më pak se 50% të kohës, me një intensitet që ndërhyr në jetën e përditshme të personit dhe ndodh herë pas here në 30 ditët e fundit (36-50%)

3 - Vështirësi e rëndë do të thotë se problemi është i pranishëm më shumë se 50% të kohës, me një intensitet që shpesh përjetohet personin nga jeta e përditshme dhe ndodh shpesh në 30 ditët e fundit (51-90%)

4 - Vështirësi e plotë/e thellë do të thotë se problemi është i pranishëm më shumë se 90% të kohës, me një intensitet që shpesh plotësisht personin nga jeta e përditshme dhe ndodh çdo ditë në 30 ditët e fundit (91-100%)

8 - Nuk aplikohet do të thotë që nuk ka përshtatje me asnjë kod të vecantë

V - Vendimi aspekti më përfaqësues për gjendjen e personit për kategorinë që do të vendoset në Certifikatën e Aftësisë së Kufizuar

	0	1	2	3	4	8	V
d1 TË MËSUARIT DHE ZBATIMI I DIJEVE	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d110 Të parët (duke përdorur shqisën e të parit qëllimisht për të përjetuar stimuj vizualë)	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d115 Të dëgjuarit (duke përdorur shqisën e të dëgjuarit qëllimisht për të përjetuar stimuj auditivë)	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d131 Të mësuarit nëpërmjet ndërveprimeve me objekte ose nëpërmjet lojës	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d133 Mësimi i gjuhës (i fjalëve, kombinimi i fjalëve në fraza, mësimi i gramatikës, etj)	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d140 Mësimi i leximit (zhvillimi i aftësive për të lexuar materialin me shkrim - duke përfshirë Braille - me rrjedhshmëri dhe saktësi, të tilla si duke njohur gërmat dhe ose /shenjat përkatëse, shqiptimi i saktë i fjalëve të lexuara dhe të kuptuarit e fjalëve dhe fjalive)	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d145 Mësimi i shkrimit (zhvillimi i aftësive për të prodhuar simbole që përfaqësojnë tinguj, fjalët ose frazat në mënyrë që të përcillet kuptimi, duke përfshirë shkrimin Braille, drejtshkrimin në mënyrë efektive dhe përdorimi i një gramatike korrekte)	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d150 Mësimi i llogaritjes (zhvillimi i aftësive për të përdorur numrat dhe kryerja e veprimeve matematikore të thjeshta dhe të ndërlikuara, të tilla si përdorimi i shenjave matematikore për mbledhjen dhe zbritjen dhe aplikimi i veprimit të saktë matematik për një problem)	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d155 Mësimi dhe përfitimi i aftësive (zhvillimi i aftësive bazë dhe komplekse në grupet e veprimeve ose detyrave të gërshetuara, në mënyrë që të nisët e të ecet më tej me mësimin e një aftësie si psh. manipulimi/përdorimi i mjeteve të ndryshme, lodrave, etj). Mësimi i një aftësie të re, për shembull, të mësuarit si të arrish në një vend të ri, si të bësh një lojë të re, etj.	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d160 Përqëndrimi i vëmendjes së qëllimshme tek stimujt e veçantë si psh. duke filtruar zhurmën shpërqëndruese.	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d177 Marrja e vendimeve , duke bërë zgjedhjen ndërmjet alternativave/mundësive/rasteve. Analizimi dhe gjetja e zgjidhjeve për problemet e jetës së përditshme.	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐



		0	1	2	3	4	8	V
d1	KRYERJA E DETYRAVE TË PËRGJITHSHME DHE KËRKESAT	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d210	Kryerja e një detyre të vetme si psh. të çuarit e pjetës në lavaman, fshirja e dhomës, hapja e një kutie, etj. (Fillimi i detyrës, organizimi i kohës, hapësirës dhe materialeve të duhura, si edhe përfundimi i detyrës). Përqëndrimi në të bërët diçka për dhjetë minuta.	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d220	Kryerja e një detyre komplekse si psh. gatimi i drekës, pastrimi i dhomës, zgjedhja e rrobave të përshtatshme për t'u veshur dhe realizimi i veshjes, vënia e kubave në mënyrë të organizuar për të krijuar një figurë, vizatimi origjinal, etj. (Fillimi i detyrës komplekse, organizimi i kohës, hapësirës dhe materielave të duhura, si edhe përfundimi i detyrës). Kujtesa për të bërë gjëra të rëndësishme.	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d230	Kryerja e rutinës së përditshme (kryerja e veprimeve të thjeshta apo komplekse dhe të koordinuara për të planifikuar, menaxhuar, plotësuar kërkesat e procedurave të përditshme apo detyrimet, të tilla si koha e buxhetimit dhe bërja e planeve për aktivitete të veçanta gjatë gjithë ditës)	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
d240	Përballimi i stresit dhe nevojave psikologjike (kryerja dhe koordinimi i veprimeve të thjeshta apo komplekse për të menaxhuar dhe kontrolluar nevojat për të kryer veprime që kërkojnë të ndërmarrësh veprime dhe përgjegjësi domethënëse, përfshirë stresin, shpërqëndrimet dhe krizat)	☐	☐	☐	☐	☐	☐	☐
